



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.426/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 9 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.426/2025, e datës 09.11.2025, parashtruar nga Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 9 Nëntor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 09.11.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë, nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më datë 9 Nëntor 2025, rreth orës 10:30, në ditën e heshtjes zgjedhore, aktivistet e Lëvizjes Vetëvendosje, kanë vërejtur se aktivisti i subjektit politik Art Mekoja në ditën e heshtjes zgjedhore, ditën e zgjedhjeve ka qëndruar në ambientet e jashtme tek rrethojat e shkollës fillore “Faik Konica”, në Prishtinë e cila gjithashtu është edhe Qendër Votimi në Komunën e Prishtinës. Tutje shtojnë se subjekti i lartcekura shkelur dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 pika 1.2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024.

Ankesës i ka bashkangjitur video incizimin.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik LDK, kundërshton pretendimet e parashtruesit të ankesës, kanë shtuar se ngjarja e referuar nuk ka ndodhur në ambientet e brendshme apo të jashtme të shkollës, por në rrugën publike, ku disa qytetar dhe aktivist kanë pritur kalimin e kryetarit. Gjatë këtij momenti nuk është zhvilluar asnjë aktivitet i organizuar zgjedhor, nuk është përdorur hapësirë apo infrastrukturë shkollore dhe asnjë personel i shkollës nuk ka marrë pjesë në çfarëdo veprimi politik. Tutje theksojnë se aktivisti i LDK-së ka qenë në sheshin “Xhorxh Bush”, vend në të cilin gjendet edhe shkolla “Faik Konica”, pra ka qenë jashtë rrethojës së shkollës, në hapësirë publike dhe jo brenda oborrit apo objektit të qendrës së votimit. Koha e xhirimit përputhet me momentin kur kryetari i LDK-së ka qenë duke votuar në këtë qendër, ndërsa aktivisti ka qenë duke e pritur kryetarin. Tutje në përgjigje theksohet se sipas rregulloreve të KQZ-së, ndalohet vetëm zhvillimi i aktiviteteve të fushatës politike brenda objekteve arsimore dhe brenda ambienteve të institucionit, mirëpo nuk ndalohet qëndrimi i qytetarëve apo aktivistëve në hapësirat publike si rruga sheshi apo trotuari, përderisa nuk pengohet rendi dhe nuk ndërhyr në proces. Kanë kërkuar nga PZAP që ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje të refuzohet si e pabazuar.

Në përgjigje në ankesë kanë bashkangjitur linqet e video incizimeve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Parashtruesi i ankesës subjekti politik LVV në ankesën e tij ka theksuar se aktivist e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ditën e votimit në ambientet e jashtme, tek rrethojat e shkollës fillore “Faik Konica”, në Prishtinë e cila gjithashtu është edhe Qendër Votimi në Komunën e Prishtinës, duke e thyer kështu heshtjen zgjedhore, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga video e dorëzuar si provë parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se aktivisti i subjektit politik LDK ka kryer veprime që bien në shkelje të dispozitave ligjore të nenit 37 par. 1 pika 2 i LZP-së, apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024.

Paneli ka vlerësuar se nga provat e ofruara si dëshmi shihet se fotografimi është bere jashtë rrethojave të vendvotimit respektivisht jashtë objektit të shkollës fillore “Faik Konica” pra videoja është bere në rrugë, e cila është shume e frekuentuar, si njëra nga rrugët kryesore të kryeqytetit, andaj kalimi i andej pari i aktivistit të LDK –se nuk vërtetohet se ka kryer aktivitet zgjedhor gjatë ditës së zgjedhjeve gjegjësisht nuk ka thyer heshtjen zgjedhore

Paneli, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të

provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.426/2025 më datën 12.11.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.